



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. 19723/Prot.

Tiranë, më 17/07/2014

(Ndryshuar me shkresë nr.19723/1, datë 31.07.2014)

(Ndryshuar me shkresën nr.566, datë 08.01.2016)

(Ndryshuar me shkresën nr.7551, datë 09.03.2016)

Lënda: Udhëzues në lidhje me zbatimin e nenit 127, pika 3 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikës 127.3 të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Drejtuar: DREJTORISË RAJONALE TATIMORE

Për dijeni: Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve

Këtu

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 10 Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikës 10.2.1 dhe 10.2.2, të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar lidhur me problemet e konstatuara për sa i takon zbatimin të nenit 127, pika 3, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikës 127.3 të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve e sheh të nevojshme hartimin dhe zbatimin e këtij udhëzuesi.

1. Në rastet kur organet tatimore kanë të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike-financiare dhe gjendet në kushtet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 127 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, procedura që do të ndiqet është si më poshtë:

1.1 Nëse punonjësi tatimor i Drejtorisë Rajonale Tatimore gjatë ushtrimit të detyrës së tij funksionale konstaton, krijon bindjen, apo ka të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacionin për gjendjen e tij ekonomike dhe financiare dhe ndodhet në kushtet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 127, të ligjit të mësipërm, menjëherë përpilon aktin e konstatimit. Akti i Konstatimit nënshkruhet nga punonjësi që e ka hartuar dhe eprori i tij direkt, dhe i drejtohet për kompetencë Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore.

Të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacionin për gjendjen e tij ekonomike dhe financiare mund të jenë:

- Përdorimi i printerave jo fiskalë në lëshimin e kuponave në pikat e shitjes, të lidhur me një njësi kompjuterike
- Lëshimi i faturave jo tatimore, të lidhura me një njësi kompjuterike, të përdorura gjatë tregëtimit, ruajtjes apo transportit të mallrave

- Përdorimi i Faturave të zakonshme Fletë Hyrje, Fletë Dalje, etj, në përdorimin, ruajtjen, dhe transportin e mallrave,
- Kupona të tjerë jo fiskalë,
- Të dhëna të tjera.

Në varësi të shkëljes administrative të konstatuar, si dhe të tagrit dhe kompetencës funksionale, punjonjësi tatimor gjithashtu vendos gjobën përkatëse për kundravajtjen administrative të konstatuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XIV, Sanksionet.

1.2 Nëse administrata tatimore ka të dhëna të besueshme, sipas përcaktimeve të pikës 1.1 të këtij udhëzuesi, (të siguruara nga denoncimet e qytetarëve dhe të verifikuara nga punonjësit përkatës brenda administratës tatimore) se tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike-financiare dhe ndodhet në kushtet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 127, të ligjit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore i cili ka në administrim tatimpaguesin, nxjerr urdhërin për sekuestrimin e paisjeve dhe/apo dokumentave të cilët fshehin situatën e tij reale dhe ekonomike.

2. Në rastet kur denoncimi është bërë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, ia përcjell denoncimin për veprim sipas këtij Udhëzuesi Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore, i cili ka në administrim tatimpaguesin brenda ditës së punës në të cilën denoncimi është bërë në D.P.T. Komunikimi midis D.P.T dhe Drejtorit të DRT-së kompetente për të përcjellë denoncimin për njohje dhe veprim mund të behet në rrugë zyrtare, elektronike, me telefon etj.

2.1. Akti i konstatimit i mbajtur në këto raste, dhe i shoqëruar me informacionin për të dhënat e konstatuara të nënshkruara nga Drejtori i Drejtorisë përkatëse të punjonjësit tatimor, i dërgohet Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore në një kohë sa më të shpejtë por jo më vonë se dita e nesërme e punës.

2.2 “Në rastet kur Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT apo Drejtoritë Hetimore Rajonale gjatë punës së tyre konstatojnë se tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike-financiare dhe ndodhet në kushtet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 127, të ligjit të mësipërm, pas miratimit të Drejtorit të Hetimit Tatimor në DPT (miratimi mund të jetë verbal ose shkresor), struktura e Hetimit Tatimor që ka konstatuar gjendjen e faktit, kryen sekuestrimin e paisjeve dhe/apo dokumentave të cilët fshehin situatën reale dhe ekonomike të tatimpaguesit”.

2.3 “Sekuestrimi i pajisjeve dhe /apo dokumentacionit kryhet nga Drejtoria përkatëse e Hetimit tatimor. Sekuestrimi detyrimisht duhet të bëhet për një kohë sa më të shkurtër, por jo më vonë se 24 orë nga koha në të cilën është evidentuar fshehja apo shkelja tatimore”.

2.4 “Sekuestrimi i pajisjeve dhe/apo dokumentacionit shoqërohet me një procesverbal të posaçëm sekuestrimi, bashkëlidhur këtij udhëzuesi, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupit të sekuestrimit dhe përfaqësuesi i tatimpaguesit (deri në prodhimin e procesverbalit drejtoria e hetimit do të veprojë me aktet e konstatimit aktuale me të cilat punojnë)”.

2.5 “Drejtorja Hetimore përkatëse njofton Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve, për sekuestrimin e bërë, i cili pas marrjes së njoftimit brenda ditës së punës ngrë grupin e verifikimit të përmbajtjes, si

dhe lajmëron me shkresë zyrtare administratorin të cilit i janë sekuestruar njësitet (kjo deri në momentin e prodhimit të procesverbalit të përmendur në pikën 2.4 të këtij udhëzuesi)”.

2.6 “Dokumentacioni dhe/apo pajisjet e sekuestruara nga Drejtoria Hetimore përkatëse që mund të përmbajnë të dhëna në formë elektronike i dorëzohen menjëherë grupit të verifikimit të ngritur nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, i cili do të veprojë sipas pikës 6 të këtij udhëzuesi”.

3. Brenda ditës së punës, Drejtori i Drejtorisë Rajonale tatimore i cili ka në administrim tatimpaguesin, nxjerr urdhrin për sekuestrimin e paisjeve dhe/apo dokumentave të konstatuara sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzuesi në përputhje me pikat 1.1 dhe 1.2. Në rast se pas nxjerrjes së urdhërit të sekuestrimit të Drejtorit Rajonal tatimpaguesit nuk i gjendet njësia kompjuterike apo dokumentacioni që është vendosur për tu sekuestruar, ky urdhër do të ngelet në fuqi dhe do të ekzekutohet në çdo moment që do të konstatohet se tatimpaguesi ka rikthyer njësinë kompjuterike apo dokumentacionin që është vendosur për tu sekuestruar. Në këto raste, administrata tatimore kryen verifikimet e nevojshme për një rrjedhje të mundshme të informacionit, si dhe ndërmer kontrollë të shpeshta dhe të vazhdueshme tek tatimpaguesi.

Në rast se tatimpaguesi nuk bashkëpunon, apo kundërshton sekuestrimin e njësinë kompjuterike apo dokumentacionin që është vendosur për tu sekuestruar, kërkohet mbështetja e organeve të policisë së shtetit, si dhe behet kallëzim penal në prokurori sipas nenit 131, pika 1,e) dhe pika 2.

4. Sekuestrimi i pajisjeve dhe /apo dokumentacionit kryhet nga grupi i sekuestrimit të Drejtorisë Rajonale në përbërje të së cilit duhet të jenë: përgjegjësi i verifikimit në terren, inspektori i verifikimit në terren i zonës përkatëse dhe një inspektor nga Drejtoria e Hetimit Tatimor të rajonit përkatës. Për arsye të mungësës objektive, Drejtori Rajonal ka tagrin të zëvendësojë perkohësisht anëtarin e grupit të sekuestrimit që mungon me një punonjë tjetër të Drejtorisë. Sekuestrimi detyrimisht duhet të bëhet për një kohë sa më të shkurtër, por jo më vonë se 24 orë nga koha në të cilën është lëshuar urdhri i sekuestrimit i firmosur nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale.

Sekuestrimi i pajisjeve dhe /apo dokumentacionit shoqërohet me një procesverbal të posaçëm sekuestrimi, bashkëlidhur, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupit të sekuestrimit dhe përfaqësuesi i tatimpaguesit.

5. Dokumentacioni dhe/apo pajisjet e sekuestruara që mund të përmbajnë të dhëna në formë elektronike i dorëzohen menjëherë grupit të verifikimit të ngritur nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve apo Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore sipas pikës 6, me proces verbal dorëzimi sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzuesi brenda ditës së punës në të cilën sekuestrimi është kryer.

6. Paisjet dhe/apo dokumentacioni i sekuestruar i nënshtrohen procedurës së verifikimit të përmbajtjes së tyre brenda një afati prej shtatë ditësh kalendarike, duke filluar nga dita e sekuestrimit.

Përbërja e grupit të verifikimit hartohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve për paisjet e sekuestruara nga Strukturat e Getimit Tatimor dhe nga Drejtori i drejtorisë Rajonale Tatimore respektive kur sekuestrimi është bërë sipas Urdhrit të Sekuestrimit të lëshuar prej tij. Në përbërje të të cilit mund të ketë një inspektor kontrolli, një inspektori vlerësimi, një punonjës hetimi sipas rastit dhe një inspektori të kualifikuar të IT. Gjatë procesit të verifikimit do të jetë edhe tatimpaguesi, apo një përfaqësues i autorizuar nga tatimpaguesi, të cilit i është sekuestruar paisja nën kontroll, i cili ka marrë dizeni nëpërmjet kopjes së procesverbalit të sekuestrimit.

Ne rast të mos paraqitjes së tatimpaguesit apo të personit të autorizuar sipas afateve të përcaktuara më sipër, dhe në kushtet e marrjes dijeni prej tij nëpërmjet procesverbalit të sekuestrimit, verifikimi kryhet pa praninë e personit të autorizuar të tatimpaguesit.

7. Grupi i Punës i ngritur sipas pikës 6, të këtij Udhëzuesim, pas ekspertizës që i bën dokumentacionit dhe/apo paisjeve të sekuestruara, përgatit Raportin për Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorin e Drejtorisë Rajonale Tatimore ku rezulton i regjistruar tatimpaguesi, brenda një afati prej 7 ditësh kalendarike.

8. Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore brenda tre ditëve e dërgon raportin e ekspertizës në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, e cila brenda tre ditëve duhet të procedojë sipas rregullave të përcaktuara në kapitullin “Kontrolli Tatimor të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 dhe manualit të kontrollit tatimor (bën rivlerësimin e ligjore dhe vendos penalitetet në përputhje me procedurat tatimore, si dhe nxjerr njoftim vlerësimin përkatës).

Nëse nga konstatimi i bërë rezulton se jemi në kushtet e përcaktuara në nenin 116 “Evazioni fiskal”, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, administrata tatimore, në përputhje me pikën 2 të nenit 131 “Veprat penale”, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe të Rregullores për bashkëpunimin mes funksioneve të veçanta të administratës tatimore, i raporton rastin D.H.T. në D.P.T. e cila pas verifikimit bën referim penal në prokurori.

9. Paisjet kompjuterike dhe dokumentacioni tatimor, pas verifikimit dhe vlerësimit i kthehen tatimpaguesit me procedurë të rregullt administrative. Nëse rasti, sipas parashikimeve të pikës 8, relatohet në prokurori, paisjet kompjuterike dhe dokumentacioni tatimor i sekuestruar administrohen për t’ju kaluar Prokurorisë në cilësinë e provave materiale, pas kërkesës së kësaj të fundit.

10. Drejtoritë Rajonale Tatimore marrin masa për njohjen e punonjësve në varësi me përmbajtjen e këtij Udhëzuesi dhe zbatimin korrekt të tij.

4. Drejtorja e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në zbatim të nenit 28 “Informimi i Publikut”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, t’u publikojë Udhëzuesin në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

BRISIDA SHEHAJ